



KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE E TË LIRIVE TË NJERIUT
COUNCIL FOR THE DEFENCE OF HUMAN RIGHTS AND FREEDOMS

Rr. Nëna Terezë nr. 24/2 – I/I, Prishtinë-Kosovë; tel. 381 (0) 249006 fax: 381 (0) 38 244029

E-mail: kmdl原因@gmail.com; <http://www.cdhrf.org>

DËSHTOI EDHE NJË SEANCË KONSTITUIVE E KUVENDIT TË KOSOVËS !

Më 14 gusht 2017 u mbajt dhe dështoi seanca e pestë (5) për zgjedhjen e organeve drejtuese të Kuvendit të Kosovës pas së cilës do t'i hapet rruga për zgjedhjen e kryeministrit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës. Koalicioni PAN, me partnerët mbështetës të pakicës serbe dhe joserbe e bëri me dije mospjesmarrjen në seancën e 14 gushtit për aq kohë sa nuk arrihet një marrëveshje politike dhe për aq kohë sa opozita nuk e kushtëzon kandidatin e koalicionit PAN për kryetar të Kuvendit. KMDLNj, që nga fillimi e ka mbështetur kryesuesin (sipas moshës) që udhëheq seancën konstituive deri në zgjedhjen e organeve udhëheqëse të Kuvendit duke kërkuar nga ai që të ruaj paanësinë politike deri sa të jetë në pozitën që e ka. KMDLNj e ka bërë të qartë që z. Mikullovc i ka të drejtë dhe nuk ka asnjë kufizim kushtetues ta thërras seancën konstituive në çdo kohë dhe pa e marrë pëlqimin nga askush dhe kjo e drejtë nuk diskutohet. KMDLNj , duke marrë parasysh gjendjen e jashtëzakonshme dhe bllokuese në Kuvend kërkon nga kryesuesi i seancës që , për shkak të ndjeshmërisë së situatës , të konsultojë të gjitha subjektet politike në mënyrë që të arrihet një konsensus politik dhe i arsyeshëm në mënyrë që të zhblokohet situata në Kuvend dhe ka kërkuar njëkohësisht nga deputetët që të marrin pjesë në një seancë të pakushtëzuar me ç'rast fuqia e votës do të ishte përcaktuese për zgjedhjen apo moszgjedhjen e kandidatëve të propozuar e jo kushtëzimi këmbëngulës i VV dhe LAA që kandidati i PAN të mos jetë kryetar të përkatësisht të mos jetë z. Veseli por një i preferuar dhe i pranuar nga opozita. KMDLNj ka qenë shumë i qartë se askush nuk mund ta kushtëzojë z. Veseli për kryetar të Kuvendit sikur që askush nuk do të kishte të drejtë ta kushtëzonte Albin Kurtin dhe Avdullah Hotin për kryeministër nëse ata e fitojnë këtë të drejtë pas dështimit eventual të PAN. VV dhe LAA vazhdojnë të këmbëngulin kundër z. Veseli ndonëse këtë të drejtë ia njeh Kushtetuta e Kosovës. VV dhe LAA mund të mos e votojnë z. Veseli për kryetar të Kuvendit por nuk kanë të drejtë ta kushtëzojnë votimin duke shantazhuar zgjedhjen e organeve drejtuese të Kuvendit me emra të përveçëm aq më parë që më parë votimi për organe drejtuese të Kuvendit ka qenë thjesht formal e që nuk po ndodhë sot . VV i ka llogaritë e saja për të shkuar në zgjedhje të jashtëzakonshme kurse LAA kushtëzimin kundër z. Veseli po e ndërlihdë me mocionin për rrëzimin e qeverisë Mustafa ndonëse me këtë mocion u rrëzua edhe pjesa qeveritare e PDK-së. Thjesht , kushtëzimi për votim me konsensus politik të organeve udhëheqëse të Kuvendit ka mbetur peng i inateve personale për shkak të një kaluare politike.

KMDLNj , duke ia njohur të drejtën z. Mikullovcit e që ia njeh Kushtetuta e Kosovës megjithatë e përkujton se nuk mund të mbahet seanca konstituive kur nuk e kemi kuorumin prej së paku 61 deputetëve e që nuk u siguroa në dy seancat e fundit ; në seancën e parafundit ishin 53 deputetë kurse në seancën e fundit 55 deputetë . Kryesuesi , z. Mikullovcit , në të dyja seancat përmes pauzës 15 minutëshe bëri përpjekje ta sigurojë kuorumin por pasi nuk u siguroa , sipas Rregullores së Kuvendit është dashur ta ndërpresë seancën e të mos lejojë debate të mbushura me gjuhën e urrejtjes dhe kërcënime të shumta. Kryesuesi i seancës nuk është dashur të lejojë eskalimin e gjuhës së urrejtjes siç ndodhi me 14 gusht aq më parë që në seancat konstituive asnjëherë nuk është lejuar debati kurse kësaj debati ishte krejtësisht i panevojshëm dhe i dëmshëm . Në seancën konstituive votohet apo nuk votohet për kandidatët e propozuar e jo që kjo seancë të shndërrohet në prokurori ilegale dhe vend për linçim të kundërshtarëve politik ndonëse ata nuk ishin të pranishëm . KMDLNj ua përkujton disa deputetëve , me përvojë të gjatë parlamentare se është e rregulluar me ligj se si zgjidhen drejtuesit e Kuvendit dhe se nuk mund të ketë zgjedhje selektive , sipas intereseve politike dhe partiake prandaj të mos e vazhdojnë bllokimin e funksionalizimit të Kuvendit përmes propozimeve të kota dhe që nuk mbështeten në ligjet në fuqi. KMDLNj konsideron se në një situatë krejtësisht të tensionuara në debate që nuk është dashur të lejohen , të vetmet diskutime të arsyeshme , shtensionuese dhe kontribuese për ecje përpara kanë qenë të Ali Lajçit nga VV , Labinot Tahirit nga LAA (AKR) dhe Naser Rugovës nga LAA (LDK).

KMDLNj i bënë ftesë publike koalicionit PAN të marr pjesë në seancat konstituive të Kuvendit të Kosovës kurse ka një kërkesë për kryesuesin e seancës z. Mikullovcit t'i përmbahet Rregullores së Kuvendit dhe të pengojë tensionimin e situatës së Kuvendit .

KMDLNj kërkon nga Prokuroria e Shtetit që t'i trajtojë me seriozitet akuzat që po bëhen në seancën e Kuvendit dhe në përputhje me faktet të veprave sipas Ligjit .

14 gusht 2017 Prishtinë

Shërbimi për Informim